



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
OPŠTINA LIPLJAN

Zyra e Kryetarit të Komunës

Pranuar me:		
Prilijeno: 04.01.2024		
Njësia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
01-052/01-810		

PROCESVERBALI NGA

KONSULTIMI PUBLIK I PLANIT

TË VEPRIMIT PËR

TRANSPARENCËN NË KOMUNËN

E LIPJANIT 2023-2027

PROCESVERBALI NGA KONSULTIMI PUBLIK I PLANIT TË VEPRIMIT PËR TRANSPARENCËN NË KOMUNËN E LIPJANIT 2023-2027

INFORMATË RRETH NJOFTIMIT

HYRJE

Në mbështetje të neneve 13, 58 dhe 68 par 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40, 41 dhe 67 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Udhëzimi administrativ UA Nr.04/2023 për administratë të hapur në komuna, Rregullores mbi Transparencën në Komunën e Lipjanit Nr. 15-353-35739, e datës 30.06.2021 si dhe Planit të Veprimit për transparencë në komunë dhe me qëllim të nxitjes dhe sigurimit të pjesëmarrjes së qytetarëve dhe palëve të tjera gjatë procesit të politik bërjes dhe vendimmarrjes së Kuvendit të Komunës së Lipjanit, Komisioni për hartimin e Planit për Transparencë në Komunën e Lipjanit 2023-2027 dhe Zyrtari përgjegjës për menaxhimin me Platformen e Konsultimeve Publike dhe Koordinimin e zbatimit të standarteve minimale të konsultimit publik në Komunën e Lipjanit kanë shpallur në:

KONSULTIM PUBLIK

Planin për Transparencë në Komunën e Lipjanit 2023-2027

Njoftimit i është bashkangjitur edhe linku i konsultimeve publike dhe linku i platformes për konsultime publike të Qeverisë së Kosovës, ku ka qenë në diskutim publik Draft Plani si edhe informatë shtesë se kujt i adresohen komentet.

Shih linqet:

<https://kk.rks-gov.net/lipjan/konsultimet-publike/dokumentet-ne-konsultim-publik/>

https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=42173&fbclid=IwAR0_jPrN3fOzDkcDRRLgzXKCWaB9ZtpGsdxzumwKKe74-OLnxVSAJRJCOig

<https://konsultimet.rks-gov.net/Storage/Consultations/16-09-57-17112023/Vendim-per-konsultimin-e-Publikut-per-planin-e-Veprimit-per-transparence-shqip.pdf>

<https://www.facebook.com/photo.php?fbid=732649102222774&set=pb.100064330733832.-2207520000&type=3>

PROCESVERBALI NGA KONSULTIMI PUBLIK I PLANIT TË VEPRIMIT PËR TRANSPARENCËN NË KOMUNËN E LIPJANIT 2023-2027

INFORMATË RRETH NJOFTIMIT

Ecuria e Procesit

Komisioni për hartimin e Rregullores në bazë të ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe dispozitave të Udhëzimi administrativ UA Nr.04/2023 për administratë të hapur në komuna në bashkëpunim me kordinatorin për konsultime publike ka publikur në web faqen e komunës kanë përgaditur njoftimin dhe kanë publikuar atë në web faqen e komunës por edhe në platformen për konsultime publike të Qeverisë së Kosovës, lidhur me mbajtjen e konsultimit për të kontribuar në këtë Plan.

<https://www.facebook.com/photo.php?fbid=741633591324325&set=pb.100064330733832.-2207520000&type=3>

<https://kk.rks-gov.net/lipjan/wp-content/uploads/sites/20/2023/12/Njoftim-per-debat-publik-Plani-i-Veprimit-per-transparence.pdf?fbclid=IwAR1irjDgiefSlucsPtxXintX9ZZZ44EpgVSUwXd5gd0np2D91CMoxi9ig-w>

Me daten 13.12. 2023 duke filluar në ora 10:00 është mbajtur debati për të konsultuar draft Planin për Transaprencë në Komunën e Lipjanit 2023-2027

Takimi përfundoi në ora 11:30

Lajmin për mbajtjen e konsultimit mund të gjeni të publikuar në vegëzën:

<https://kk.rks-gov.net/lipjan/news/mbahet-debat-i-hapur-publik-per-draft-planin-e-veprimit-per-transparence-2023-2027/>

PROCESVERBALI NGA KONSULTIMI PUBLIK I PLANIT TË VEPRIMIT PËR TRANSPARENCËN NË KOMUNËN E LIPJANIT 2023-2027

INFORMATË RRETH DEBATIT PUBLIK

Nën kryesimin e Bukurie Zejnullahu- Jashari u zhvillua debati. Fillimisht ajo ka përshëndetur gjithë të pranishmit duke i falënderuar për pjesëmarrje si dhe prezantoi anëtarët e komisionit të cilët hartuan draft Draft Planin në fjalë:

1. Bukurie Zejnullahu-Jashari kryesuese
2. Burim Gashi –anëtarë
3. Qendresa Jashanica –Dërmaku –anëtare
4. Valdete Muji –anëtare
5. Linda Shahini – anëtare

Bukurie Zejnullahu-Jashari, prezantoi dhe lexoi në terësi draft Planin për Transaprencë në Komunën e Lipjanit 2023-2027 dhe informoi të pranishmit se ky dokument aktualisht është në fazën e konsultimeve me publikun dhe se planifikohet të dërgohet për shqyrtim dhe miratim në seancën e radhës së Kuvendit Komunal.

Ajo po ashtu para të pranishmëve tha se Komuna e Lipjanit përmes Planit të Veprimit për Transparencë komunale ka për qëllim t'i ofrojnë publikut qasje të lehtë në mbikëqyrjen dhe zbatimin e politikave nga organet e komunës, duke përfshirë informim të shpejtë, të dhëna të qasshme, publikimin e të gjitha akteve normative dhe dokumenteve me interes publik, si dhe rritje të mundësive të pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse.

Znj. Zejnullahu-Jashari ka potencuar se Udhëzimi Administrativ Nr.2020/03 për Transparencë në Komuna përcakton dhe obligon që Komunitat të hartojnë planin katër (4) vjeçar të veprimit për transparencë. Me këtë plan, Komuna e Lipjanit do të ndërmer veprime konkrete në promovimin dhe ofrimin e transparencës së plotë tek: Aktivitetet dhe vendimmarrja e Kryetarit të Komunës, mbledhjet e Kuvendit të Komunës; mbledhjet e komiteteve; takimet publike; takimet konsultative për projektakte; transparencën në planifikimin dhe shpenzimin e buxhetit të komunës; qasje të shpejtë në shërbime; procedura transparente në aktivitetet e prokurimit; procedura transparente të punësimit; përditësimin e vazhdueshëm të aktiviteteve ditore në faqe zyrtare të komunës; përfshirjen aktive të qytetarëve në hartimin dhe zbatimin e politikave dhe akteve tjera që i konsideron komuna të domosdoshme për konsultim.

Besojmë që ky plan veprimit për transparencë do të jetë një ndihmesë në rritjen e efikasitetit të shërbimeve, në krijimin e një ambienti më transparent të punës në administratë, rritjen e besimit të qytetarëve ndaj të zgjedhurve të tyre publike, gatishmërisë dhe përkushtimit më të madh, si dhe përpjekjeve për të fuqizuar e përmirësuar sistemin e menaxhimit brenda komunal.

PROCESVERBALI NGA KONSULTIMI PUBLIK I PLANIT TË VEPRIMIT PËR TRANSPARENCËN NË KOMUNËN E LIPJANIT 2023-2027

INFORMATË RRETH DEBATIT PUBLIK

Në fund të këtij takimi komisioni për hartimin e këtij drafti kanë kërkuar nga të pranishmit dhe gjithë qytetarët lipjanas që të jenë sa më aktive gjatë fazës së konsultimit publik të këtij Plani në mënyrë të kemi një dokument sa më gjithëpërfshirës.



Diskutimi u bë në mënyrë të hapur ku u diskutuan shumë çështje lidhur me Planin e Veprimit për Transparencë, përmes të cilit synojmë të kontribuojë në ndërtimin e një administrate komunale llogaridhënëse dhe transparente, të hapur për qytetarë dhe shoqërinë civile në të gjitha proceset vendimmarrëse.

Metodat e Konsultimit	Datat/kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve/konsultimin publik-kontribuesve
1. Konsultimet me shkrim/në mënyrë elektronike	30 ditë pranohen	15
2. Publikimi në ueb faqe	30 ditë	

Në këtë takim konsultativ kanë marrë pjesë **15** pjesëmarrës, prej tyre **11** femra dhe **4** meshkuj.

PROCESVERBALI NGA KONSULTIMI PUBLIK I PLANIT TË VEPRIMIT PËR TRANSPARENCËN NË KOMUNËN E LIPJANIT 2023-2027

INFORMATË RRETH DEBATIT PUBLIK

Erblina Salihu-qytetare, ka pyetur se a është i paraparë në këtë Plan zbatimi dhe monitorimi i Planit të veprimit për Transparencë

Bukurie Zejnullahu-Jashari, kryesuese e Komisionit për hartimin e këtij dokumenti ka theksuar se zbatimi i Planit të Veprimit për Transparencë 2023 – 2027 i Komunës së Lipjanit do të mbikëqyret në vazhdimësi me mekanizma përkatës, do të rishikohet periodikisht dhe do të azhurnohet në përputhje me ndryshimet ligjore, institucionale, procedurale dhe të personelit, në varësi të ndikimeve nga mjedisi i jashtëm apo i brendshëm i komunës.

Vesa Rrahmani –Studente ka pyetur se është përfshirë në Planin e Transparencës e gjithë procedura e prokurimit publik

Komisioni ka potencuar përmes këtij Plani është paraparë Publikimi i Raportit vjetor të zbatimit të Planit për prokurim public si dhe publikimi I të gjitha procedurave të prokurimit.

Kaltrina Sopa- studente ka thënë se dua të dijë se a janë të specifikune konsultimet publike në këtë dokument dhe procedurat lidhur me afatet për kontributin e qytetarve dhe grupeve të interesit.

Anëtarët e Komisionit për hartimin e Planit kanë thënë se po në këtë dokument është përfshirë e gjithë procedura e konsultimeve publike duke filluar nga Përgatitja e planit të veçantë për të gjitha propozimet e akteve nënligjore dhe politikave lokale, të cilat i nënshtrohen procesit të konsultimit publik gjatë vitit. Informimi me kohë për dokumentet, projekt-aktet, mënyrat dhe format e konsultimit, vendin dhe afatet e konsultimit publik përmes zbatimit të standardeve minimale të konsultimit publik në nivel lokal dhe në fund nxjerren të procesverbale dhe raportet e konsultimeve publike për secilin akt apo dokument që i është nështruar konsultimit publik.

Bukurie Zejnullahu-Jashari

Zyrtare përgjegjëse për kordinimin e konsultimeve publike